

VENDIM
Nr. 802, datë 30.9.2015

PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË SHOQËRISË TRANS ADRIATIC PIPELINE AG (TAP AG), NËPËRMJET MARRJES NË PËRDORIM DHE KRIJIMIT TË SERVITUTIT TË PËRHERSHËM NË SIPËRFAQET E TOKAVE SHTETËRORE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I KORRIDORIT TË NDËRTIMIT DHE KORRIDORIT TË SISTEMIT TË GAZSJELLËSIT, TË PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 16 e 27.1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës dhe të pjesëve 1 e 3, të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vënien në dispozicion të shoqërisë Trans Adriatic Pipeline AG (TAP AG) të sipërfaqeve të tokës shtetërore, nëpërmjet marrjes në përdorim të përkohshëm, me kontratë qiraje për korridorin e ndërtimit, si dhe nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm për krijimin e servitutit të kalimit, me qëllim ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit, që nuk është toka e infrastrukturës brenda korridorit të ndërtimit, të cilat do të shërbejnë në ndërtimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).

2. Sipërfaqja totale e tokës shtetërore referuar destinacioneve që përfshihen në pikën 1 është 2 774 749.00 (dy milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e dyzet e nëntë) m² dhe vihet në dispozicion të projektit TAP, me dhe pa kompensim, sipas kushteve të mëposhtme:

a) Nëpërmjet marrjes në përdorim të përkohshëm me kompensim për korridorin e ndërtimit, me gjerësi përgjithësisht 52 metra, i nevojshëm për ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit, të sipërfaqeve prej 1 899 013.00 (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e trembëdhjetë) m², për tokat shtetërore publike, të kategorizuara si truall, toka bujqësore, sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullësor, tokat shtetërore jopublike të përcaktuara sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi referuar hartave dhe planeve përkatëse të rievimit. Marrja në përdorim të përkohshëm bëhet për një periudhë 24-mujore, me kompensim, nëpërmjet pagesës së qirasë, të llogaritur sipas planit të rehabilitimit të jetesës.

b) Nëpërmjet marrjes në përdorim të përkohshëm pa kompensim për korridorin e ndërtimit, me gjerësi përgjithësisht 52 metra, i nevojshëm për ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit, të sipërfaqeve prej 512 205 (pesëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e pesë) m², për tokat shtetërore që gjenden në shtretërit dhe brigjet e lumenjve, të përrrenjve apo rrjedhave të tjera ujore, liqeneve dhe rezervuarëve natyrorë ose artificialë, tokat e kategorizuara rrugë automobilistike, si dhe tokat e kategorizuara shkëmbore, të përcaktuara në shtojcën 2 bashkëlidhur këtij vendimi referuar hartave dhe planeve përkatëse të rievimit. Marrja në përdorim të përkohshëm bëhet për një periudhë 24-mujore pa kompensim.

c) Nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm me kompensim për krijimin e servitutit të kalimit në Korridorin e Sistemit të Gazsjellësit, me gjerësi përgjithësisht 8 metra, të sipërfaqeve prej 289 672.00 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) m², për tokat shtetërore publike, të kategorizuara si truall, toka bujqësore, sipërfaqe të fondit pyjor dhe kullësor, tokat shtetërore jopublike të përcaktuara sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi referuar hartave dhe planeve përkatëse të rievimit. Marrja në përdorim të përhershëm për krijimin e servitutit të kalimit bëhet me kompensim, të llogaritur sipas planit të rehabilitimit të jetesës.

ç) Nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm pa kompensim për krijimin e servitutit të kalimit në Korridorin e Sistemit të Gazsjellësit, me gjerësi përgjithësisht 8 metra, të sipërfaqeve prej 73 859 (shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë) m², për tokat shtetërore që gjenden në shtretërit dhe brigjet e lumenjve, të përrrenjve apo rrjedhave të tjera ujore, liqeneve dhe rezervuarëve natyrorë ose artificialë, tokat e kategorizuara rrugë automobilistike, si dhe tokat e kategorizuara shkëmbore, të përcaktuara sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij vendimi referuar hartave dhe planeve përkatëse të rievimit. Marrja në përdorim të përhershëm për krijimin e servitutit të kalimit bëhet pa kompensim.

3. Vlera e kompensimit për sipërfaqen totale prej 2 188 685.00 (dy milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë

mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë) m², marrë në përdorim sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 2, të këtij vendimi, është 189 797 528.79 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e tetë pikë shtatëdhjetë e nëntë) lekë.

4. Krijimi i servitutit të kalimit në Korridorin e Sistemit të Gazsjellësit, sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 2, të këtij vendimi, u nënshtrohet këtyre kufizimeve:

a) Ndalimit të ndërtimit të strukturave në tokë urbane;

b) Ndalimit të mbjelljes së pemëve (kultura shumëvjeçare) apo plugimit të tokës në thellësi në tokë bujqësore;

c) Ndalimit të ndërtimit të strukturave apo mbjelljes së pemëve në tokë kullotë;

ç) Ndalimit të mbjelljes së pemëve në tokë pyll.

5. Sipërfaqja e tokës shtetërore, me gjerësi përgjithësisht prej 52 m për korridorin e ndërtimit, si dhe sipërfaqja me gjerësi përgjithësisht prej 8 metra për Korridorin e Sistemit të Gazsjellësit, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij vendimi, përfshihet në territorin administrativ të njërive të qeverisjes vendore, si më poshtë vijon:

a) Në territorin administrativ të Bashkisë Berat, të Qarkut të Beratit, për:

i) sipërfaqen truall në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 1 253 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 382 556 (treqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh;

ii) sipërfaqen tokë bujqësore (arë e pemëtore dhe ledh e ullishtë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 127 635 (njëqind e njëzet e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 19 928.00 (nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e tetë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 28 476 501.00 (njëzet e tetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e një) lekësh;

iii) sipërfaqen fond pyjor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 235 635.00 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 (tetë) metra, në total 35 467.00 (tridhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 11 164 884.25 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet e pesë) lekësh;

iv) sipërfaqen fond kullor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 1 157.00 (një mijë e njëqind e pesëdhjetë e shtatë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 155.00 (njëqind e pesëdhjetë e pesë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 114 473.00 (njëqind e katërmëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) lekësh;

v) sipërfaqen pa fryt, varreza në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 5 479 (pesë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 596 (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m², pa kompensim;

vi) sipërfaqen ujore (përrua, kanal, kënetë, lumë, zallishte), me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 26 072 (njëzet e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra në total 3 309 (tre mijë e treqind e nëntë) m², pa kompensim;

vii) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 41 757 (dyzet e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 5 359 (pesë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) m², pa kompensim.

b) Në territorin administrativ të Bashkisë Ura Vajgurore, të Qarkut të Beratit, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë, ullishtë dhe vreshtë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 4 439.00 (katër mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 238.00 (dyqind e tridhjetë e tetë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 932 896.75 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh;

ii) sipërfaqen fond kullor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 57 777.00 (pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 9 526.00 (nëntë mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 5 043 457.00 (pesë milionë e dyzet e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë) lekësh;

iii) sipërfaqen ujore (përrua, kanal) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 17 147 (shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e shtatë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 922 (një mijë e nëntëqind e njëzet e dy) m², pa kompensim;

iv) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 9 140 (nëntë mijë e njëqind e dyzet) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 676 (një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m², pa kompensim.

c) Në territorin administrativ të Bashkisë Poliçan, të Qarkut të Beratit, për:

i) sipërfaqen truall në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 660.00 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 132.00 (njëqind e tridhjetë e dy) m², me vlerë të përgjithshme prej 269 016.00 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëmbëdhjetë) lekësh;

ii) sipërfaqen tokë bujqësore (arë, pemëtore dhe ullishtë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 54 730.00 (pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 8 940.00 (tetë mijë e nëntëqind e dyzet) m², me vlerë të përgjithshme prej 11 580 386.75 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh;

iii) sipërfaqen fond pyjor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 47 332.00 (dyzet e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 6 780.00 (gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 2 260 788.75 (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh;

iv) sipërfaqen fond kullor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 47 676.00 (dyzet e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 7 554.00 (shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 4 247 959.25 (katër milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë njëzet e pesë) lekësh;

v) sipërfaqen varreza në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 971 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 3 (tre) m², pa kompensim;

vi) sipërfaqen ujore (përrua, kanal, moçal, lumë, ranishte) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 42 428 (dyzet e dy mijë e katërqind e njëzet e tetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 5 835 (pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) m², pa kompensim;

vii) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 23 042 (njëzet e tre mijë e dyzet e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 2 946 (dy mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) m², pa kompensim.

ç) Në territorin administrativ të Bashkisë Skrapar, të Qarkut të Beratit, për:

i) sipërfaqen truall (truall) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 298.00 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh;

ii) sipërfaqen tokë bujqësore (arë e pemëtore dhe ledh) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 175 419.00 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 28 100.00 (njëzet e tetë mijë e njëqind) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 14 664 267.25 (katërmëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë njëzet e pesë) lekësh;

iii) sipërfaqen fond pyjor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 444 193.00 (katërqind e dyzet e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 67 649.00 (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 34 270 958.54 (tridhjetë e katër milionë e dyqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë pikë pesëdhjetë e katër) lekësh;

iv) sipërfaqen fond kullor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 168 430.00 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 24 550.00 (njëzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 8 059 607.75 (tetë milionë e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatë pikë shtatëdhjetë e pesë) lekësh;

v) sipërfaqen pa fryt në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 7 945 (shtatë mijë e nëntëqind e dyzet e pesë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 042 (një mijë e dyzet e dy) m², pa kompensim;

vi) sipërfaqen ujore (kanal dhe lumë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 76 363 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tre) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 14 103 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e tre) m², pa kompensim;

vii) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 29 540 (njëzet e nëntë mijë e pesëqind e dyzet) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 2 755 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) m², pa kompensim.

d) Në territorin administrativ të Bashkisë Devoll, të Qarkut të Korçës, për:

i) sipërfaqen truall në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 546.00 (pesëqind e dyzet

gjashtë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 20.00 (njëzet) m², me vlerë të përgjithshme prej 191 952.00 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekësh;

ii) sipërfaqen tokë bujqësore (arë e mekan dhe mezhde e rripe) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 36 896.00 (tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 5 598.00 (pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², me vlerë të përgjithshme prej 3 187 907.00 (tre milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatë) lekësh;

iii) sipërfaqen shkëmbore në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 5 261 (pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 106 (një mijë e njëqind e gjashtë) m², pa kompensim;

iv) sipërfaqen ujore (përrua, kanal, moçal, lumë dhe ranishte) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 31 381 (tridhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë e një) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 4 683 (katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) m², pa kompensim;

v) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 20 608 (njëzet mijë e gjashtëqind e tetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 4 031 (katër mijë e tridhjetë e një) m², pa kompensim.

dh) Në territorin administrativ të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë, ledh dhe vreshtë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 118 852.00 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 18 375.00 (tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 15 026 948.00 (pesëmbëdhjetë milionë e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e dyzet e tetë) lekësh;

ii) sipërfaqen fond pyjor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 3 669.00 (tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 260.00 (dyqind e gjashtëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 378 807.00 (treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatë) lekësh;

iii) sipërfaqen fond kullor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 171 379.00 (njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 26 400.00 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 11 880 200.00 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind) lekësh;

iv) sipërfaqen shkëmbore, mal, varreza në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 14 887 (katërmëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 881 (një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) m², pa kompensim;

v) sipërfaqen ujore (përrua, kanal, kënetë, lumë) me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 44 555 (dyzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 5 847 (pesë mijë e tetëqind e dyzet e shtatë) m², pa kompensim;

vi) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 20 626 (njëzet mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 2 614 (dy mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë) m², pa kompensim.

e) Në territorin administrativ të Bashkisë Maliq, të Qarkut të Korçës, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 1 789.00 (një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 401.00 (katërqind e një) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 530 099.00 (pesëqind e tridhjetë mijë e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh;

ii) sipërfaqen fond kullor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 552.00 (pesëqind e pesëdhjetë e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 86.00 (tetëdhjetë e gjashtë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 56 000.00 (pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh;

iii) sipërfaqen ujore (kanal, ranishte) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 7 922 (shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 289 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë) m², pa kompensim;

iv) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 8 359 (tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 065 (një mijë e gjashtëdhjetë e pesë) m², pa kompensim.

ë) Në territorin administrativ të Bashkisë Fier, të Qarkut të Fierit, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë dhe ledh) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 119

855.00 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 18 235.00 (tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e pesë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 24 242 937.50 (njëzet e katër milionë e dyqind e dyzet e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë pikë pesë) lekësh;

ii) sipërfaqen fond pyjor (sipas zërave kadastralë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 2 862.00 (dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 440.00 (katërqind e dyzet) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 191 116.00 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh;

iii) sipërfaqen ujore (përrua, kanal, moçal, lumë, zallishte) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 13 071 (trembëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e një) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 1 940 (një mijë e nëntëqind e dyzet) m², pa kompensim;

iv) sipërfaqen rrugë, hekurudhë, vendstrehim në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 50 013 (pesëdhjetë mijë e trembëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 7 463 (shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) m², pa kompensim.

f) Në territorin administrativ të Bashkisë Roskovec, të Qarkut të Fierit, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 66 976.00 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 9 937.00 (nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 11 551 406.00 (njëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e gjashtë) lekësh;

ii) sipërfaqen ujore kanal në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 5 871 (pesë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 906 (nëntëqind e gjashtë) m², pa kompensim;

iii) sipërfaqen rrugë automobilistike në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 4 361 (katër mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m², pa kompensim.

g) Në territorin administrativ të Bashkisë Lushnjë, të Qarkut të Fierit, për:

i) sipërfaqen tokë bujqësore (arë) në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 4 616.00 (katër mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 901.00 (nëntëqind e një) m², me vlerë të përgjithshme kompensimi prej 1 036 502.00 (një milion e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dy) lekësh;

ii) sipërfaqen rrugë automobilistike, hekurudhë në korridorin me gjerësi përgjithësisht 52 metra, në total 5 406 (pesë mijë e katërqind e gjashtë) m² dhe servitutit me gjerësi përgjithësisht 8 metra, në total 821 (tetëqind e njëzet e një) m², pa kompensim.

6. Për sipërfaqet e tokës shtetërore, që vendosen në dispozicion të shoqërisë TAP AG me kompensim, të cilat preken nga ndërtimi i projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP) dhe që vihen në përdorim të përkohshëm me kontratë qiraje për korridorin e ndërtimit ose merren në përdorim të përhershëm për krijimin e servitutit të kalimit me qëllim ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit, sipas pikave 2.a. dhe 2.c. më sipër, vlera e pagesës së kompensimit paguhet nga shoqëria TAP AG, në emër të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, për llogari të buxhetit të shtetit. Vlera e pagesës për tokën shtetërore llogaritet sipas planit të rehabilitimit të jetesës për marrjen në përdorim të tokës shtetërore sipas formës së përcaktuar në pikën 1, nëpërmjet kontratës për pagesën e qirasë dhe servitutit të përhershëm, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe shoqërisë TAP AG. Pagesa për tokën shtetërore nga ana e shoqërisë TAP AG të bëhet sipas vlerave të përcaktuara në pikën 5, të këtij vendimi, për:

a) sipërfaqet truall, që janë pronë shtetërore;

b) sipërfaqet tokë bujqësore, (arë, pemëtores dhe vreshtë);

c) sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullësor (pyll, kullotë, livadh dhe sipërfaqe me bimësi pyjore).

7. Sipërfaqet e tokës shtetërore të vëna në dispozicion të përkohshëm të shoqërisë TAP AG, sipas përcaktimeve të pikës 2, shkronjat “a” dhe “b”, për t’u përdorur për korridorin e ndërtimit të Gazsjellësit të projektit TAP, vihen në dispozicion të shoqërisë TAP AG deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe rehabilitimit të sipërfaqes së prekur. Shoqëria TAP AG paraqet të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, në rast se për nevoja të projektit kërkohet shtyrje e afatit të përdorimit të sipërfaqeve të tokës shtetërore.

8. Në rast të evidentimit të ndryshimeve të mundshme, gjatë fazës së kryerjes së punimeve në korridorin e ndërtimit dhe Korridorin e Sistemit të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), të cilat sjellin

ndryshime në sipërfaqet e tokave shtetërore të vëna në dispozicion të shoqërisë TAP AG, shoqëria TAP AG paraqet në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë kërkesën për ndryshimet e nevojshme në projekt, së bashku me dokumentacionin përkatës, ku të jenë dhënë edhe ndryshimet që kërkojnë të bëhen në sipërfaqet e tokave shtetërore, të vëna në dispozicion të saj në funksion të këtij vendimi.

9. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bazë të kërkesës së shoqërisë TAP AG për rishikimin e kushteve të lejes për ndryshime në projektin e ndërtimit të sistemit të gazsjellësit për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), duke u bazuar në dokumentacionin përkatës, procedon me miratimin e shpejtë të ndryshimeve të nevojshme në lejen për punimet ndërtimore dhe bën njoftimin e ministrive/institucioneve përkatëse, si dhe të njëjsteve të qeverisjes vendore për ato sipërfaqe të tokave shtetërore që janë përfshirë në ndryshimet e propozuara sipas projektit TAP.

10. Në përfundim të punimeve të ndërtimit të Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit të projektit TAP, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria TAP AG, përgatit dhe paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave ndryshimet e mundshme për sipërfaqet faktike të tokave shtetërore dhe efektet financiare që krijohen si rezultat i këtyre ndryshimeve të sipërfaqeve faktike të tokave shtetërore që janë vënë në dispozicion të shoqërisë TAP AG dhe që preken nga ndërtimi i sistemit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, për sipërfaqet e tokave shtetërore që vendosen në dispozicion të shoqërisë TAP AG, nëpërmjet marrjes në përdorim të përkohshëm me kontratë qiraje për korridorin e ndërtimit, si dhe nëpërmjet marrjes në përdorim të përhershëm për krijimin e servitutit të kalimit me qëllim ndërtimin e Korridorit të Sistemit të Gazsjellësit, që nuk është toka e infrastrukturës brenda korridorit të ndërtimit, nga ana e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë:

a) të kryhen procedurat për përditësimin dhe ndryshimet në fondin pyjor/kullosor kombëtar, si dhe ndryshimin e kategorisë së përdorimit të resursit të tokës bujqësore, si dhe për sipërfaqet e fondit pyjor e kullosor, që preken nga ndërtimi i sistemit të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP).

b) të bëhet njoftimi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për regjistrimin e së drejtës së servitutit mbi pasuritë tokë shtetërore, të vëna në dispozicion të shoqërisë TAP AG sipas listave të shtojcave 1 dhe 2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe njësitë e qeverisjes vendore, ku kalon projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

